



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.03.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.07.2008”” .

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Vullnet Sinaj, Luan Duzha, Luan Harusha, Aqif Rakipi, Antoneta Dhima, Spartak Braho, Elena Xhina, Anduel Xhindi.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu, Myslim Murrizi, Flamur Noka, Isuf Çelaj, Xhemal Gjunksi, Ervin Saliq, Anton Frrokaj.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatos Bundo - Drejtor i KESH-it

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Në rendin e ditës së këtij komisioni kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.07.2008”.

Për të prezantuar këtë projektligj kemi ftuar ish-kolegun tonë zotin Ilir Bejtja zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Faleminderit!

Mirë se keni ardhur në komisionin tonë!

Zotin Agim Bregasi, drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Faleminderit!

Zotin Fatos Bundo, drejtor i KESH-it.

Faleminderit!

Përpara se t'i jap fjalën zotit Bejtaj do të doja të thosha arsyet pse jeni në Komisionin për Sigurinë Kombëtare. Është hera e parë që për një projektligj të tillë, përfaqësuesit e Ministrinë së Infrastrukturës dhe Energjisë thirren në këtë komision. Arsyeja është se siguria e digave është një ndër elementet e asaj që konsiderohet si infrastrukturë kritike.

Nga ana tjetër, siguria e digave në mënyrë direkte ose indirekte lidhet edhe me një funksion të veçantë sikurse është ai që ushtron drejtoria e Emergjencave Civile, një drejtori, e cila përgjigjet te Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Pra, parë nga ky këndvështrim e gjykuam se ishte e nevojshme edhe për anëtarët e këtij komisioni, të jenë më në dijeni të marrëveshjeve që lidhen me këtë sektor dhe për këtë arsye i kërkuam Konferencës së Kryetarëve, Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi që kjo marrëveshje të mund të shqyrtohej edhe në komisionin tonë. Ne nuk jemi komisioni përgjegjës për këto marrëveshje, por komision për dhënie mendimi. Do të sugjeroja edhe për shkak të natyrës së punës së komisionit tonë, të përqendrohemi në aspektin e sigurisë, sigurinë reale, në atë se çfarë sjell kjo marrëveshje për sigurinë e digave, çfarë është e reja dhe si mendohet në vijim të garantohet sigurimi i saj në mënyrë të plotë. Relatore për këtë projektligj është zonja Dhima.

Fjalën e keni ju zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Ky projekt nuk nis me këtë marrëveshje, është një projekt që vazhdon prej shumë vitesh me asistencën financiare të Bankës Botërore dhe me fondet e garantuara nga buxheti i shtetit me garanci sovranë që i janë dhënë gjeneratorit tonë, gjeneruesit të energjisë elektrike, KESH-it për të garantuar një funksionim normal dhe të sigurt të 3 digave të kaskadës së Drinit.

Po e filloj me fjalinë që duam të dëgjojmë të gjithë: digat janë 100% të sigurt. Ka një rregullore, e cila rregullon regjimin e përdorimit të tyre, është rregullorja e funksionimit të digave. Për dijeninë tuaj aty janë të përcaktuara qartazi të gjithë treguesit që duhet të respektojmë në shfrytëzimin e 3 liqeneve, të 3 ujëmbledhësve dhe të digave, të cilat bëjnë të mundur krijimin e këtyre ujëmbledhësve.

Ne kemi vazhduar me disa projekte, të cilat e kanë rritur këtë siguri, siç ka qenë ndryshimi i kanaleve të shkarkimit në Koman, forcimi i portave të shkarkimit në Vaun e Dejës më përpara, restaurimi i turbinave në hidrocentralin e Komanit, i cili vazhdon ende sot e kësaj dite dhe përfshin elemente të sigurisë, të funksionimit të tyre, po kështu edhe në liqenin dhe digën e Fierzës jemi duke vazhduar me rehabilitimin të turbinave, por edhe të pjesës tjetër teknike që lidhet me funksionimin e digës dhe të hidrocentralit në përgjithësi, duke filluar nga diga deri te kanali, bashkë me pjesën që garanton edhe rrjedhjen e ujit në mënyrë të lirshme, në rrjedhën e tij normale, por edhe kur ne kemi ngarkesa të tepërta me ujë, të cilat kanë edhe 2 komitete të rëndësishme që janë: Sekretariati i Plotave, i cili është organizuar brenda KESH-it dhe Komiteti i Plotave, i cili drejtohet nga ana ime, nga ministria, marrin vendime në raste të veçanta kur duhet të dalim përtej kushteve që parashikon rregullorja. Në përgjithësi respektojmë rregulloren, nëse marrim vendime, të cilat na japin mundësinë të bëjmë biznes edhe përtej kushteve ekstreme këto bëhen në respektim të parashikimeve që vijnë nga burime të ndryshme: nga metrologjia, nga Ministria e Mbrojtjes, nga pushteti lokal, që përfaqësohet nga qarku dhe nga prefektura e Shkodrës, që të gjithë janë pjesë e këtyre dy strukturave të rëndësishme dhe vendimet janë 100% të rakorduara. Pastaj i drejtohen Kryeministrit për informacion sesi procedohet. Flasim për një aset, i cili është me të vërtetë një nga asetet më të rëndësishme nga pikëpamja strategjike e sigurisë në Shqipëri, jo thjesht për sigurinë energjetike të vendit, një kolaps energjetik të mundshëm që do të shkaktonte një problem në kaskadën e Drinit, që nuk menaxhohet nga KESH-i, por edhe nga OST-ja, e cila bën monitorimin dhe kombinimin e hyrjes së energjisë në rrjet nga prodhuesit,

nga KESH-i apo nga importi, po ashtu edhe të planifikimit të konsumit nga ana e OSHEE-së. Pra, është një veprimtari tejet e kontrolluar dhe e rakorduar.

Projekti që flasim është një projekt, i cili i përgjigjet një faze normale, një procedure normale, rehabilitimi i disa elementeve të vërejtura me probleme të vogla ose me probleme gjatë funksionimit në këto 3 diga ka filluar dhe vazhdon, ne jemi në kuotën rreth 86 milionë euro investime në këto diga me Bankën Botërore. Kemi pasur mundësinë të gjejmë vazhdimisht mbështetje edhe nga qeveria që e ka pasur gjithmonë prioritet kaskadën e Drinit.

Për sa i përket projektit, është një pjesë e shërbimit për projektin, janë 300 mijë euro, të cilat alokohen për supervizionin e projektit në vazhdim prej 12 milionë eurosh që keni miratuar rreth 6 muaj më parë për sigurinë e digave, por nuk kemi parashikuar fondin e supervizimit, pasi e kishim gjendje nga *tracet* e mëparshme. Duke qenë se jemi brenda po të njëjtit objekt, është i mundshëm të rialokohet nga kredia e mëparshme në këtë kredi me kohë të hapur.

Ekspertiza është e huaj, sepse ne nuk e kemi në Shqipëri, por gjatë gjithë procesit shoqërohen nga stafi shqiptar i KESH-it, që bëjnë të mundur edhe mbylljen e procesit, por edhe krijimin e kapaciteteve brenda normales.

Tani, në qoftë se ju duhet ndonjë informacion më specifik, do të ishte mirë të më pyesnit më tepër.

Ermonela Felaj – Besoj se do të ishte më efektive. Sidoqoftë, faleminderit për prezantimin nga ana juaj!

Natyrisht, është shumë e rëndësishme të dimë se kaskada e Drinit të menaxhohet siç duhet, për shkak se aty janë tre hidrocentralet më të mëdha në vend. Në të shkuarën, kam parasysh këtu vitin 2010, mosmenaxhimi i duhur cenoi jashtëzakonisht shumë jo thjesht ekonominë...

Ilir Bejtaj – Bëhej me telefon atëherë, ose me mors.

Ermonela Felaj – Prandaj, rastet e së kaluarës nuk duhet të përsëriten në asnjë mënyrë.

Fjalën do t'ia kaloj zonjës Dhima, për të bërë një përshkrim të shkurtër si relatores. Më pas, kolegët janë të ftuar për të drejtuar pyetje.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit për prezantimin, zoti zëvendësministër!

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese, të marrëveshjes së financimit për projektin siguria e digave, nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, ratifikuar me ligjin numër 9965, datë 27. 7. 2008.

Ndryshimi që synohet të miratohet nëpërmjet këtij dokumenti, është rishpërndarja e fondeve të akorduara nëpërmjet kësaj marrëveshjeje nga kategoria 3 në kategorinë 2 të saj. Objektivat kryesore të projektit të sigurisë së digave, në kuadrin e Programit për Komunitetin e Energjisë së Europës Juglindore, janë:

E para, rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të sistemit elektroenergjetik shqiptar në kaskada e lumenjve Drin dhe Mat. E dyta, rritja e sigurisë dhe e cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të eficiencës së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar kështu edhe në rritjen e qëndrueshmërisë së sigurimit të furnizimit me energji elektrike në tregun e rajonit të energjisë.

Nëpërmjet rishpërndarjes së fondeve të marrëveshjes së financimit për sigurimin e digave synohet financimi i konsulentit të implementimit të projektit për detyrat e mëposhtme, të cilat janë përfshirë në kategorinë 2 të marrëveshjes, po për shkak të punimeve shtesë, të evidentuara në rehabilitimin elektromekanik të HEC-it të Komanit, aktivitet i cili është pjesë e kësaj marrëveshjeje, kërkohet financimi shtesë për supervizimin e punimeve rehabilituese elektromekanike të agregateve në HEC-in e Komanit. Kjo për arsye se kontrata me konsulentin në lidhje me projektin e sigurisë së digave është e tipit Time Bage Contact dhe jo çmim fiks, dhe sa herë që kërkohen aktivitet shtesë, që është përfshirë në projektin e sigurisë së digave, duhen amenduar kontratat e konsulentit.

E dyta, fondet e lira, të angazhuara në kategorinë 3, në shumën 300 mijë euro, kalohen në kategorinë 2, shërbimet e konsulentëve, me qëllim mbulimin e kostove për supervizimin e punimeve dhe financimin e panelit të pavarur të ekspertëve për projektin e sigurisë së digave. Shtyhet afati i kësaj marrëveshjeje deri më datën 31. 12. 2020. Njëkohësisht, shtyhet dhe afati i mbylljes së kredisë, po përsëri më datë 31. 12. 2020.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Bejtaj – Është aspekti më i rëndësishëm, por nuk kemi qenë pjesë.

Ermonela Felaj – Ne si Komision i Sigurisë duhet të fillojmë të ndryshojmë qasjen, duke u përqendruar në atë gjë, e cila është pjesë e punës tonë, ndërkohë që ana financiare nuk është pjesë mirëfilli e punës sonë, por e Komisionit të Ekonomisë.

Mirë. Faleminderit, zonja Dhima!

Në këto çaste do t'i uroj mirëseardhjen kolegut tonë Ylli Shehu, i cili është përcaktuar të jetë anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare

Ndërkohë, kemi pyetje nga kolegët? Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

Si deputet i qarkut Shkodër, kisha diçka për të thënë në lidhje me zonën e Dajçit. E para e punës, disa familje kanë mbetur pa u shpërblyer nga përmbytjet e vitit 2011. A thua është e mundur të realizohet kjo? Sepse kemi kërkesa nga qytetarët.

Pyetja e dytë: në lidhje me digën që është në atë zonë aty, a është në varësinë tuaj? Në fakt, jo digë, por argjinatura e fshatit, e cila është dëmtuar.

Kaq kisha.

Ermonela Felaj – Zoti Bejtaj.

Ilir Bejtaj – Sa i takon shpërblimit, është një proces, i cili ka nisur shumë herët. Një pjesë e tyre janë rakorduar edhe me konsumin e energjisë. Kush ka pasur teprica, pra më shumë dëm të krijuar nga çka pasur detyrime energjie, ka qenë gjithnjë i ftuar që të vijë t'i marrë. Ato juanë me listë. Në qoftë se ndonjëri nuk ka ardhur, duhet të paraqitet pranë zyrave të KESH-it ose të OSHEE-së, në njërën nga këto.

Luan Harusha – Jam në dijeni të këtyre shpërndarjeve, por disa persona nuk janë debitorë, por nuk u jepet shpërblimi. Ku duhet të drejtohen?

Ilir Bejtaj – Te OSHEE ose te KESH-i, njëra nga të dyja.

Luan Harusha – Kanë shkuar, por nuk gjejnë zgjidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull! Faleminderit!

Ermonela Felaj – Megjithatë, ne kemi edhe drejtorin e KESH-it.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ok, drejtori i projekteve. Mendova ashtu ngaqë e kisha të shënuar KESH.

Luan Harusha – Sepse ka një mosmarrëveshje. KESH-i, OSHEE, nuk e dinë si funksionon.

Ilir Bejtaj – Le të vijnë te unë, në ministri, dhe e zgjidhim. Nuk ka problem. Vetëm se duhet një listë.

Luan Harusha – Do ta marr listën dhe do të ta sjell personalisht.

Ermonela Felaj – Zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt kam pyetje të thjeshtë. Natyrisht që ato tri diga që përmendët ju janë me rëndësi të veçantë. Patjetër që edhe më parë është kërkuar kujdes, qoftë për menaxhimin, qoftë për investimin, pavarësisht asaj çfarë thatë ju më parë. Patjetër që kjo lloj marrëveshjeje nënkupton se do të ketë investime për mirëmbajtje, por edhe për sigurinë fizike, me roje apo jo, këtë ide s'e kam shumë të qartë.

Pyetja ime është: Komiteti i Digave a vazhdon të jetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e administron këtë?

Ilir Bejtaj – Komiteti i Digave merret me digat e vogla dhe me rezervuarët. Strukturat e vetme që menaxhojnë digat janë KESH-i, që i ka nën përgjegjësi direkte administrative, nga pikëpamja teknike e operimit dhe e mirëmbajtjes, dhe dy strukturat e tjera që, siç jua thashë, merren me regjimin e funksionimit të tyre brenda rregullores: Sekretariati i Plotave dhe Komiteti i Plotave ("plota" i quajmë kur ka mbingarkesë ujore).

Sadi Vorpsi - Meqë na sqaruat për çështjet e Komitetit të Digave, kam një pyetje për informacion, meqë reforma administrative territoriale u dha të gjitha bashkive menaxhimin e ujëmbledhësve, nga relacionet e bashkive dhe të prefekturave, çfarë rezulton sot?

Agim Bregasi - Në fakt, kalimi i të gjitha digave në administrim të bashkive ka krijuar një situatë tjetër, sepse bashkitë nuk kanë kapacitetet teknike financiare për të mirëmbajtur digat. Janë rreth 640 diga që u kanë kaluar bashkive. Ajo që ka bërë Komiteti i Digave është një inventarizim i plotë i të gjitha digave dhe problematikat që kanë këta. Edhe zonja ministre që në takimet e para ka thënë se do të ketë një projekt për të bërë një inventarizim, por edhe për të parë problematikat që ka çdo digë. Në bazë të këtij studimi do të arrihet në konkluzionin se në cilat diga duhet ndërhyrë dhe për çfarë, sepse mund të ketë diga që nuk e kanë më funksionin për të cilin janë ndërtuar para 40 vjetësh. Maskuria është një nga më të rrezikshmet, por që ka bërë disa ndërhyrje emergjente para dy vjetësh, por bashkitë realisht nuk i përballojnë dot shpenzimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komisioni i Sigurisë Kombëtare natyrisht që duhet të ketë një informacion të plotë nga Komiteti Kombëtar i digave, sepse përbëjnë realisht një problem për shkak të vjetërsisë, pasi kanë 40 vjet që janë ndërtuar ato diga dhe janë amortizuar mekanizmat e hapjes dhe të mbylljes. Gjithashtu, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë ka zënë pjesën poshtë digave, që është një problem më vete, ka ndërtime mbi diga, ka llumra poshtë digave. Të gjitha këto janë

pjesë e një projekti që do të përgatitet, pastaj do të sigurohet edhe financimi për secilën nga këto diga.

Siç thashë, bashkitë nuk i kanë mundësitë financiare, prandaj do të kërkohet një financim me donatorët nëpërmjet qeverisë për të bërë një ndërhyrje totale.

Realisht ka një projekt me Bankën Botërore, ku këto diga ishin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe 12 prej tyre janë në proces ose janë rehabilituar. Rehabilitimi është një histori shumë e qartë.

Ermonela Felaj – Zoti Bejtja.

Ilir Bejtja - Normalisht kjo duhej të ishte edhe zgjidhja, ne e kemi të verifikuar këtë që pushteti lokal nuk ka kapacitete që t'i menaxhojë. Pra, kemi të bëjmë me raste të kontrollit të territorit, sepse bëhet fjalë për individë që mbjellin pemë në digë dhe nuk e lënë të filtrohet ose mbi digë ndërtohet edhe agroturizmi. Çështja është se nuk menaxhohet dot mirëmbajtja e digave nga pushteti lokal, duhet të kalojnë ose në varësi të Ministrisë së Energjetikës, ose të një strukture të veçantë permanente për këtë qëllim.

Ermonela Felaj – Zoti Bejtja, a ka ndonjë propozim nga ministria juaj për menaxhimin e 640 digave që u janë dhënë në administrim bashkive, që të mund të kalojnë prapë nën administrimin e një institucioni qendror, ose të një institucioni të dedikuar vetëm për sigurinë e digave? Sipas mendimit tim, kjo çështje mbart një diskutim vërtet shumë të rëndësishëm duke marrë parasysh edhe ngjarjet që kanë ndodhur në botë. Është vërtet një bombë me sahat, që nuk duhet lënë gjatë në këtë gjendje. Nëse jemi në vitin e katërt të kryerjes së reformës administrative territoriale dhe shohim që ka momente, të cilat nuk administrohen dot, siç duhet, pavarësisht vullnetit dhe dëshirës së mirë dhe argumenteve të fillimit, unë mendoj se nxitja jonë duhet të jetë më e madhe që t'i rikthejmë disa nga këto funksione aty ku ato janë më të natyrshme për t'u ushtruar. A ka ndonjë hap nga ministria, apo duhet që Komisioni i Sigurisë në këtë momente, duke marrë një informacion të tillë, të mundet të shtrijë ndikimin e vet edhe pranë ministrisë suaj dhe të kërkojë informacion të detajuar nga Komiteti i Digave, madje t'ia shtrojë çështjen edhe Këshillit të Ministrave për një ndërhyrje?

Ilir Bejtja - Ne kemi bërë mbledhje para një muaji me kryetarin e komitetit dhe me përfaqësues nga KESH-i. Jemi duke bërë një studim, i cili ka një kosto rreth 2900 -3000 euro për digë, për verifikimin e gjendjes së tyre fizike dhe monitorimin. Këtë do ta përballojmë me fonde brenda sistemit. Nuk kemi ndërmarrë ende hapa ligjorë që të bëjmë propozim qeverie që të kalojnë përsëri në administrim qendror. Kjo do të dalë në fund të studimit pasi të dimë

saktësisht sa prej këtyre rezervuarëve janë funksionalë, sepse i kemi në inventar 640 diga, por do të monitorohen të gjitha. Gjithashtu, do të studiohet sa janë të rrezikshme ose që kërkojnë elemente të rëndësishme sigurie. Megjithatë, do të ishte ndihmë edhe nga ana juaj si komision nëse do të thirrej edhe Komiteti i Digave dhe kjo lëvizje do të ishte nga të dy krahët. Ne do të mund ta iniciojmë një vendim qeverie të tillë, por ka të bëjë me një ligj që lidhet me decentralizimin e pushteteve. Sot është kompetencë e pushtetit lokal, dhe nuk kërkon vetëm ndryshim VKM-je.

Ermonela Felaj - Sigurisht që kërkon një vullnet të cilësuar!

Ilir Bejtja – Ne e kemi si përgjegjësi që e ushtrojmë ende, edhe pa e pasur. Kini parasysh që studimin do ta bëjmë me fondet e KESH-it, që nuk është normale, kur ato duhet të kenë fondet e tyre, garancinë, fond sigurie, roja, struktura të monitorimit, inxhinierë, se nuk është thjesht le një roje e mbaroi puna, por gjendja e tyre duhet të monitorohet herë mbas here.

Ermonela Felaj - Në digat e mëdha ne kemi stacionet sizmike.

Siguria e digave të mëdha mbulohet tërësisht me këto letërmarrëveshjet ndryshuese?

Më falni që po ia marr fjalën koleges, po ngaqë jemi në të njëjtën temë, doja t'ju pyes: Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim “IDA”, është nga ato shoqatat tipike që ofron ndihmë në këtë sektor? Do të doja të dija diçka më tepër rreth kësaj shoqate, se çfarë përfaqëson, çfarë ndihme ofron dhe a është e mjaftueshme kjo që ne të jemi të sigurt që digat e mëdha janë maksimalisht të siguruara nëpërmjet këtyre fondeve që vë në dispozicion qeveria shqiptare ose faktori ndërkombëtar?

Zoti Bundo, fjala për ju.

Fatos Bundo – Shoqata, në fakt, është Banka Botërore, institucion i saj dhe jo një shoqatë nga shoqëria civile. Është kontribut i bankës, ka një bord prej 9 drejtorësh ekzekutivë në Bankën Botërore, e cila ka dy instrumente: Bankën Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Rindërtim dhe shoqatën “IDA”, të dy këto instrumente e financojnë gjithmonë Bankën Botërore. Deri më tani gjithë fondet e dhëna qoftë nga Banka Ndërkombëtare, qoftë shoqata “IDA”, siç e përmendi edhe zëvendësministri, kanë përballuar më së miri të gjithë projektin e sigurisë së digave.

Në vijim të pyetjes që bëri zoti Vorpsi, do të thosha që ne kemi eksperiencë shumë të mira me Bankën Botërore, praktikisht kemi përgatitur 3 plane emergjence për secilën nga digat: Vaun e Dejës, Komanin dhe Fierzën dhe ua kemi dërguar zyrtarisht autoriteteve lokale, Komitetit të Emergjencave dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha. Këto plane

emergjencash janë projekte shumë të fuqishme, janë të gatshme për zbatim dhe kanë filluar. Janë detajuar me kujdes duke filluar që nga hartat e përmbytjes në rastet e skenarëve të ndryshëm që mund të ndodhin, skemat e evakuimit, skemat e sinjalizimit, përllogaritjet se si duhet të bëhen në rastin e një pllote shpejtësie të lëvizjes dhe këto dokumente janë zyrtare tashmë, të miratuara nga Komiteti Kombëtar i Digave dhe u janë shpërndarë prefekturave.

Në kuadër të këtyre studimeve që po bëjmë për të gjitha digat e tjera, kjo eksperiencë mund të përdoret shumë mirë, domethënë, në qoftë se flasim për 3 digat e mëdha, digat e tjera janë pak më të vogla dhe planet e tyre të emergjencave do të jenë edhe më të thjeshta, por gjithsesi metodologjia dhe skema janë të zbatueshme edhe për këto dhe ky fakt mund të shfrytëzohet. Zyrtarisht, janë dërguar tek autoritetet lokale për të gjitha digat dhe kjo është bërë me asistencën e Bankës Botërore.

Faleminderit, zoti Bundo, për sqarimet!

Ermonela Felaj – Zonja Dhima, kishte një pyetje.

Antoneta Dhima – Një nga objektivat tuaj është edhe rritja e sigurisë dhe cilësisë me energji elektrike. Pyetja ime është: si paraqitet gjendja e burimeve hidrike sot?

Faleminderit!

Ilir Bejtja – Sistemi ynë hidro bazohet në reshje, në prurjet e basenit të lumit Drin. Është situatë shumë kritike, në Fierzë jemi rreth 268 metra, që nuk kemi qenë ndonjëherë në këtë periudhë, është nivel historik minimal. Nuk ka pasur reshje tashmë që nga korriku i vitit të kaluar deri në nëntor-dhjetor dhe kemi arritur në 7-8 metër kub në sekondë në disa raste në lumin Drin. Pra, po e përballojmë çdo gjë me blerje energjie nga importi dhe shumë pak prodhim nga KESH-i. Aktualisht, prodhimi i KESH-it është 10 milionë kilovatë orë në ditë.

Megjithatë, lidhur me pyetjen e radhës që kishit, nëse do të vazhdojë e njëjta situatë, do të ulemi deri në 5 milionë kilovatë orë në ditë, që do të thotë se kemi rritur importet. Presim të kemi një ndryshim të programit ekonomik në OSHEE, ku do të ndalojmë të gjitha investimet për vitin 2019, në mënyrë që të garantojmë fonde të mjaftueshme për furnizimin me energji të popullatës, por është 100% e garantuar. Ky është problemi ynë brenda sistemit, por që nuk transmetohet absolutisht te konsumatori fundor.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Bejtja!

Fjala për Luanin.

Luan Harusha – Doja të bëja një pyetje: a bashkëpunoni me OSHEE-në dhe me Ministrinë e Bujqësisë për zonat e përmbytura, sepse ato përmbyten dhe këto lekë që hidhni vit pas viti mua më duket sikur janë të hedhur kot. Duhet bërë një studim, duhen bërë

pastrime, të hapen kanale ose të bëhet ndonjë projekt, sepse këto lekë që hidhen çdo vit, më duket se hidhen kot.

Faleminderit!

Ilir Bejtja –Unë kam informacion si anëtar qeverie, por jo në mënyrë direkte, sepse ato mbulohen nga Ministria e Bujqësisë. Di që kemi qenë së bashku në një njësi livrimi prioritetesh për një periudhë të gjatë dhe janë investuar mjaftueshëm, ose shumë para edhe nëpërmjet drejtorive të bujqësisë nëpër rrethe, nëpërmjet stacioneve që kanë e që janë të alokuara pranë bashkive dhe janë pastruar disa qindra kilometër kanale ose disa mijëra, do të thosha.

Megjithatë, kjo nuk lidhet vetëm me kanalet e evakuimit të ujërave. Është një sistem i përgjithshëm i evakuimit të menaxhimit të ujërave, i cili nuk funksionon në mënyrë të harmonizuar. Si OSHEE ne bëjmë çmos që të mos mungojë energjia. Kemi arritur që në çdo zonë, ku ekziston rreziku i përmbytjeve, të ketë disa mënyra furnizimi dhe të mos ketë ndërprerje energjie. Në shumë raste, kur ka përmbytje, energjinë e ndërpresim vetë, sepse mund të ketë rrezik, mund të bjerë kabina në ujë, ose niveli mund të jetë i tillë sa nuk mund të lëshojmë as rrymë nëpër shtëpi, sepse bëhet hataja, por në kaskadë, të paktën në këta 5 vjet, kemi treguar që kemi qenë të kujdesshëm, gati perfekt, në kombinimin e ujërave të hedhura në shtratin e lumit, flas gjithmonë për lumin Drin, dhe në sasinë e energjisë që kemi prodhuar, pa e derdhur ujin kot.

Në prill të vitit të shkuar ne arritëm të mos kemi rrezik në zonë, vetëm në disa zona, ku janë krejtësisht nën ujë dhe argjinaturat janë relativisht të vjetra. I kemi kërkuar Komitetit të Plotave, e kemi edhe me procesverbal, e kemi çuar edhe në Komitetin e Emergjencave Civile në Kryeministri, i drejtuar nga zëvendëskryeministrja, një ndërhyrje në një zonë të lumit Buna për të shtuar kapacitetin thithës nga 1700-1800 metër kub të shkojë në 2300 metër kub në sekondë. Gërryerja e kodrës kërkon 15-20 milionë euro, që do të ishte një zgjidhje shumë e rëndësishme dhe do të krijonte mundësinë të evadonte më shumë ujë drejt bregut. Lumi Buna nuk thith vetëm nga Lumi Drin, aty sjell Kiri, sjell liqeni i Shkodrës dhe bëhet liqen më vete, por jemi munduar ta menaxhojmë në mënyrë perfekte. Prandaj, dua të them se dëmet kanë qenë të papërfillshme në raport me atë që historikisht ka ndodhur.

Luan Harusha – Ju i dëmshpërbleni fshatarët e zonave të përmbytura...

Ilir Bejtja – Dëmshpërblimi është vendosur me vendim qeverie në mënyrë arbitrare në dëm të KESH-it në vitin 2010, me arsyetimin që KESH-i nuk e menaxhoi dot situatën. Në

fakt, në këto raste nuk dëmshpërblen KESH-i, por, në bazë të ligjit të emergjencave civile, është qeveria që e bën dëmshpërblimin.

Luan Harusha – Ju thatë se në muajin prill të vitit të shkuar situata është menaxhuar shumë mirë, por në muajin prill tokat bujqësore dolën të gjitha jashtë funksionit.

Ilir Bejtja – Dalin edhe sikur të mos ketë hidrocentrale. Ne nuk kemi hedhur ujë poshtë Fierzës më shumë sesa prurjet normale të vetë lumit. Ne kemi bërë të mundur se çfarë ka pasur tepriçë ujërash, i kemi menaxhuar duke krijuar rezerva dhe duke e mbajtur. Pra, punojmë 10 ditë para, ku presim se do të ketë plota, që të krijojmë kapacitete rezervë që të mos kemi teprica në shtratin e lumit. Pra, në Bunë, në Drin dhe në Vaun e Dejës ne nuk kemi asnjëherë litra më shumë sesa prurjet normale të lumit.

Agim Bregasi – Meqenëse zoti Harusha është nga Shkodra, dua t'ju them një kuriozitet. Në vitin 1966 ka qenë një vendim qeverie, i cili përcaktoi që argjinatura e Drinit në anën e Kosmaçit ose të Bushatit të kishte një vend më të ulët, në mënyrë që të shkarkoheshin ujërat e tepërta që vinin nga Drini dhe të përmytej fusha, ku është bërë stacioni i Bushatit, por në atë kohë në atë zonë nuk kishte banesa. Pra, ishte e ditur që ajo zonë do të përmytej, prandaj ishte vënë ajo valvul sigurie që prurjet të mos shkonin në Shkodër, por e linin të përmytej fusha. Studentët, shokët tanë nga Shkodra, shpesh vinin dhe thoshin që kemi ecur mbi ujë se ishte përmytur rruga. Pra, këto janë fenomene të prurjeve natyrale, por digat kanë bërë rregullimin e prurjeve dhe komiteti, në zbatim të rregullores së plotave, ka për qëllim që të sigurojë funksionimin e digave, të ketë prodhim maksimal dhe përmytje minimale. Pra, nuk përjashtohen përmytjet, por e rëndësishme është ta menaxhojmë.

Në ligjin për digat dhe për emergjencat shprehet qartë që, nëse vërtetohet se dëmi ka ardhur nga KESH-i, atëherë e dëmshpërblen KESH-i.

Luan Harusha – Unë jam i ri në moshë dhe nuk e kam arritur vitin 1966, por Dajçi dhe Shirqi janë ndër fshatrat më të vjetër në Shkodër dhe në vitin 1966 lumi Buna ka pasur një mjet që e ka pastruar këtë lum. Domethënë, që atëherë ka funksionuar, ndërsa sot nuk funksionon.

Ermonela Felaj – Megjithatë, problemi është që menaxhimi nuk po funksionon siç duhet në këtë pikë.

Ilir Bejtja – Zoti Harusha ndoshta sheh vetëm atë pjesën aty, por problemi krijohet te dy ishujt, që janë pengesa e parë që rrisin nivelin. Domethënë, pastrimi duhet të jetë i përhershëm, njëlloj siç bëjmë me pjesën tjetër të menaxhimit, por kjo del jashtë

kompetencave tona dhe ne po diskutojmë për prurjet normale dhe natyrale të dy lumenjve. Domethënë, ne nuk e shtojmë këtë, por mundohemi ta fenojmë. Rezerva që kemi në Fierzë, pavarësisht se për ne nuk është e favorshme, sepse jemi në vështirësi për të prodhuar energji, garantohet se këtë vit Shkodrës nuk do t'i hyjë asnjë gram uji nëpër taka, sepse kemi vend sa të duash ku ta mbajmë. Domethënë, edhe sikur të sjellë 3 apo 4 herë më tepër ujë, Drini duhet të bjerë shi 1 muaj rresht që të shkojë në nivelin e rregullores, por që nuk ka për të rënë këtë vit.

Dua të them se këto diga e ndihmojnë situatën poshtë, nuk e vështirësojnë. Domethënë, po të mos ishin çfarë vjen sipër, do të dilte poshtë. Duhet të keni parasysh se vitin 2010, përsëri digat kanë ndihmuar. Në atë kohë mbaj mend zotin Berisha, i cili dilte nëpër lajme çdo gjysmë ore, në pamundësi për të dhënë zgjidhje, sepse prurjet kanë qenë 3900 metër kubë në sekondë. Pra, është çmenduri të derdhet liqeni i Shkodrës, ta ngresh në këmbë dhe ta hedhësh në fushë!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A mund të bëj dhe unë disa pyetje dhe më pas t'i japim fund diskutimit?

Në fjalën tuaj thatë se do ta bëni studimin për çdo digë, duke e mbështetur këtë studim tërësisht në fondet tuaja. Sa kohë mendoni se do të marrë ky studim?

Sa i integroni ju diskutimet tuaja për çështjen e sigurisë së digave me Ministrinë e Bujqësisë dhe me Drejtorinë e Emergjencave Civile? A mendoni se ka ardhur momenti që Drejtoria e Emergjencave Civile të dalë nga roli që përballon vetëm pasojat? A mendoni se duhet të japim një rol edhe më aktiv emergjencave civile për faktin, ato janë dëshmitare të situatë në terren, sepse ndërhyjë atëherë kur ndodh pasoja. Në momentin që përballojnë pasojat, kanë mundësinë e plotë, që të analizojnë shkaqet pse ndodhin këto pasoja. Pra, këto shkaqe të mos mbajmë thjesht për vete apo për t'i ndarë me ne, por t'i ndajnë me ente, që fuqinë e tyre mund ta përdorin në parandalim.

Pyetja ime e fundit lidhet me Komitetin e Digave, mendoj se Komiteti drejtohet nga zëvendëskryeministri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të na thoni diçka më shumë për përbërjen dhe kujt i jep llogari ky Komitet? Si mundet ky që t'i bashkërendojë bashkitë në të gjitha detyrimet që kanë? Pra, po përpiqemi pak më shumë diskutimin përtej marrëveshjes për t'i dhënë mundësi Komisionit të Sigurisë që të kuptojë si mund ta organizojë më mirë përgjegjësinë e tij në raport me këtë çështje.

Ilir Bejtja – Në lidhje për projektin, nuk besoj se do të zgjasë më shumë se 1 vit. Mbas mbledhjen me ministren ne i kemi lënë detyrë kryetarit të Komitetit, zotit Muçaj, që të na sjellë një listë të përgjithshme të ndërhyrjeve, ku ai kërkon të ketë monitorim më të intensifikuar. Për shifrën e përafërt, që ata na kanë prezantuar, besoj se është përballueshme. Ashtu siç e thashë, do të gjejmë mundësi ta financojmë me fondet e KESH-it ose të sistemit, pra nuk do të shkojmë në qeveri që të presim kur të ketë alokime.

Në lidhje me Drejtorinë e Emergjencave Civile, është një shqetësim i ngritur historikisht nga ana e tyre dhe para 3-4 vjetësh është krijuar brenda çdo dikasteri, çdo ministrie një njësi koordinimi për emergjencat civile, por që nuk është komitet i mirëfilltë ose zyrë e mirëfilltë, përbëhet nga 3-4 persona, të cilët në momente të caktuara janë pjesë e së tërës e emergjencës civile, por shqetësimi i tyre gjithmonë ka qenë i lidhur me profilaksinë. Pra, një studim i ngjashëm si ky, që ne do të bëjmë për digat, mund të bëhet për çdo argjinaturë të baseneve të lumenjve në Shqipëri, pra kudo ku ne kemi rreziqe të kësaj natyre. Tashmë janë verifikuar rreziqe në Jug të vendit, jo aq shumë në Veri. Domethënë, harta hidrologjike ndryshon edhe sipas hartës metrologjike dhe reshjeve në vend. Për këtë arsye mendoj se nuk mund të zgjidhet brenda kuadrit të ministrisë tonë, sepse nuk kemi mundësinë që t'i mbulojmë për fushë veprimi. Pra, janë të përfshira, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit, pushteti vendor, prefekturat dhe basenet në vetvete, si institucione, është diçka shumë e gjerë. Normalisht kjo mund të drejtohej vetëm në nivel Kryeministrie.

Agim Bregasi - Në fakt, Komiteti i Digave është një institucion që varet nga Kryeministria, nuk ka lidhje me ministrinë, por për arsye infrastrukture është futur te Ministria e Infrastrukturës. Tani që jemi bashkuar është në kuadrin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Detyra e këtij Komiteti, është të bëjë një pasqyrim të situatës së digave në vendin tonë, qoftë ato të bujqësisë apo të hidrocentraleve që po ndërtohen nga privatët, dhe të kërkojnë një raport dhe mbi to pastaj të japi edhe rekomandimet për secilin nga digat. Por për problemet që dalin nga kompetencat e Komitetit i drejtohet çdo vit me një raport Këshillit të Ministrave (jam anëtar i Komitetit Kombëtar të Digave, prandaj them se e njoh situatën).

Me kalimin pranë pushtetit vendor, ne bëmë një presion shumë të madh në fillim të vitit të shkuar, kur u bashkuam si ministri, për të pasur një inventar dhe gjendjen fizike të digave shumë nga bashkitë i drejtoheshin Komitetit dhe i thoshin duam kaq lekë, duam kaq fonde, situata kështu, situata ashtu. Kjo nuk është në kompetencën tonë, sepse Komitetit i

Digave nuk ka fonde për të financuar projekte të ndryshme, ka vetëm asistencë teknike dhe monitorimin që duhet ta bëjë për digat në mënyrë periodike. Është propozuar edhe një ndryshim ligjor, që të ketë një inspektorat me 2-3 veta, për të mos e rënduar financimin e këtij monitorimi, i cili do të ketë një kalendar, një grafik për të monitoruar të gjitha digat dhe për të marrë kontakte me pushtetin vendor në mënyrë permanente dhe për të prezantuar situatën. E gjithë situata lidhet me financimin, pra se kush do ta bëjë financimin për mirëmbajtjen e këtyre digave. Përveç kësaj, ajo që tha edhe zoti Vorpsi, nisur nga eksperiencia që ka në pushtetin e vendor, ky i fundit i ka kapacitetet e kufizuara qoftë të specialistëve, por edhe ajo që është më e rëndësishmja, edhe të buxhetit për të ndërhyrë. Pra, komiteti i digave këtë funksion ka. E bën prezent, por siç e thatë edhe ju dhe, në kuadër të komisionit tuaj, duhet një bashkërendim i forcave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të Emergjencave Civile, që të mos i lëmë në momentin kur të ndodhë situata, por të paraprijnë. Duhet gjetur një zgjidhje me një institucion qendror që mund t'i ketë në administrim për të parë projektet dhe të financojë. Kjo çështje nuk na përket neve, por në përgjithësi ky është edhe organizimi i Komitetit Kombëtar të Digave dhe mundësitë që ka ai deri në sensibilizimin apo dërgimin e raporteve pranë Këshillit të Ministrave. Në funksion të tyre është edhe një sekretariat teknik, ka edhe specialistë të vjetër që janë marrë me projektim digash. Herë pas herë shkojnë atje ku është pika më kritike, si rasti i Manskurisë, i Tapizës apo në diga të tjera, ku janë kërkuar nga pushteti vendor për ekspertizë të mirëfilltë teknike, por nuk ka financim.

Ilir Bejtja – Edhe një herë, zonja kryetar, këtu problem është edhe regjimi ditor i këtyre digave. Kur kanë në qenë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, koordinimi i përqendruar i tyre bënte të mundur që edhe regjimi ditor i tyre të ishte i monitoruar, sepse ato përdoren për vaditje për bujqësinë, pra jo se na kanë mbetur aty dhe ne nuk kemi çfarë të bëjmë me to. Për pasojë, edhe regjimi i tyre, menaxhimi i tyre nuk mund të bëhet nga barinjët. Po të shikosh situatën nëpër bashki, shpesh janë lënë në mëshirë të fatit, ose ai që ka shtëpinë afër, bën edhe ruajtjen. Ka raste që përdoren edhe për ujë të pijshëm. Brenda ngordhin kafshë, pra ka situata nga më dramatiket dhe janë verifikuar, pra nuk është se nuk i di njeri. Mënyra se si ne e kemi zgjidhur, e shoh shumë të vështirë koordinimin që pushteti qendror të ketë monitorimin, dikush poshtë t'i operojë po në të njëjtat standarde. Nuk po e diskutoj çështjen e përgjegjshmërisë, se ajo mund të jetë në çdo nivel, por çështjen e standardit të përgatitjes së personit që merret me digën. Ka ende gjëra dramatike dhe të kësaj natyre. Për shembull, tek tre rezervuarët e mëdhenj të Funarit është shkatërruar porta e

shkarkimit, uji tashmë rrjedh lirshëm aty ka bërë vendin, kanali që ka marrë rreth 1 miliardë e gjysmë lekë të vjetër, domethënë mbi 1 milion e 200 mijë euro nuk ekziston fare, pra ne jemi në një situatë tani që themi të shtyjne sa të shtyjne. Nëse ju e merrni këtë iniciativë, kjo do të ishte një ndihmë shumë e madhe. Pastaj mendoni edhe një element tjetër, të përgjegjësisë sociale. Mbarojnë të gjitha ata studentë për hidrologji dhe nuk dinë ku të punojnë, sepse thashë që digat i menaxhojnë barinjtë.

Ermonela Felaj – Duket shumë e drejtë nisur nga mënyra se si ju e ngrini problemin dhe e ndani me ne, sepse edhe në përgjegjësinë tonë si deputetë të zonave të ndryshme nuk është se nuk e kemi konstatuar këtë lloj problematike, madje e kemi konstatuar dhe kemi parë se është nga ato problematika që ka qenë e vështirë për t'u shtyrë përpara. Ndërkohë që ju po shpjegoni, unë solla ndërmend faktin që ne përpara dy vjetësh bëmë një reformë shumë të madhe, që ishte reforma e kanaleve ujitëse. Sigurisht, u dhanë shumë lekë, mjete për të 61 bashkitë. Mbas 28 vjetësh filloi kjo reformë e rëndësishme, ndërkohë di që Ministria e Bujqësisë vijon të financojë projekte që lidhen me kanalet vaditëse etj., por gjëja që nuk kam unë të qartë, ose që nuk më rakordon, është nëse vendoset të financohen projekte të tilla, a merret edhe mendimi i institucioneve që janë përgjegjëse në këtë fushë dhe a dinë shkallën e rëndësisë, sepse edhe ju e thatë në fjalën tuaj 640 diga të vogla nuk janë njësoj as për nga rëndësia dhe as për nga mundësia për t'i rikthyer në aktivitetin e mëparshëm? Mund të ketë mes tyre që mund të jetë të pakthyeshme, sikurse ka të tjera ku duhet ndërhyrë sa më shpejt. Pra, mendoj se një qasje duhet ta kemi edhe në këtë pikë. Këto projekte që bashkitë ia kërkojnë vazhdimisht Ministrisë së Bujqësisë të financohen, vendosen apriori, i vendos Ministria e Bujqësisë apo në këto projekte duhet të ketë edhe një opinion nga ana e personave që janë më teknikë, më të profilizuar në këtë çështje, sikurse ka sens që në bashki na mungojnë kapacitete të tilla njerëzore? Ky është problem për të 61 bashkitë e Shqipërisë dhe ndoshta menaxhimi duhet të jetë me një njësi të posaçme dhe duhet të jetë tërësisht qendror, hierarkik i përqendruar. Sidoqoftë, do t'ju falënderoj për të gjitha ato që ju ndatë me ne!

Ilir Bejtja – Ne, zonja kryetare, do t'ju sjellim një informacion shumë të kompletuar për këtë çështje për të gjitha digat që ne kemi të identifikuar si problematika. Nuk mund t'ju propozojmë diçka për mënyrën e menaxhimit, sepse thashë që edhe ne nuk jemi kompetentë në atë aspekt. Ato janë diga të një natyre tjetër. Zakonisht i ka menaxhuar Ministria e Bujqësisë. Menaxhimi i tyre lidhet me përdorimin. Gjithsesi, do t'jua sjellim këtë dhe shpresojmë që edhe ju të jeni një forcë në këtë lëvizje.

Ermonela Felaj – Shumë faleminderit!

Ne do t'i mbajmë shënim këto, sepse do të na duhet ky informacion për të ndërtuar edhe ne komunikimin tonë, sikundër duhet t'ju përgëzoj, por edhe do të mbajmë shënim si komision që pas një viti të mund ta kemi studimin tuaj për të gjitha digat e vogla, sepse një vit duket kohë e gjatë, por koha ecën edhe shpejt. Kështu që është momenti i duhur dhe realisht ia vlen të përgëzoheni për këtë iniciativë që keni ndërmarrë.

Do të ftoj kolegët të kalojmë në votimin e këtij projektligji. Kush është dakord me projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 9965, datë 24.07.2008”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Ka një abstenim.

Miratohet.

Faleminderit për mundësinë që na dhatë të ishim së bashku!

Punë të mbarë!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA